

ASC – 10 – 0018

Në padinë e

██████████, **person fizik**

Skënderbeu, Kamenicë

Përfaqësuar nga ██████████, avokat në Gijlan

Paditësi/Ankuesi

Kundër

██████████, **NSH**

Kamenicë

I Padituri

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetari i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, lidhur me ankesën e Paditësit/Ankuesit kundër aktvendimit të DHPGJS-së të datës 14 janar 2010, SCC-09-0117, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 gusht 2010, lëshon këtë

AKTVENDIM

- 1. Ankesa hedhet poshtë si e papranueshme.**
- 2. Ankuesi obligohet ta paguajë taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumën prej 60 eurove tek Dhoma e Posaçme.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësi i kërkoi DHPGJS-së të vërtetojë se ai është pronari ligjor i banesës dhe të obligohet i Padituri t'i njeh të drejtat e tij pronësore.

Më 14 janar 2010, Trupi Gjykses lëshoi një aktvendim (SCC-09-0117) me anë të së cilit e refuzoi padinë si të papranueshme.

Më 12 shkurt 2010, Paditësi (tash e tutje Ankuesi) parashtroi një ankesë pranë DHPGJS-së kundër aktvendimit të Trupit Gjykses.

Më 16 mars, Ankuesit i ishte kërkuar të paraqiste brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve nga pranimi i urdhrin datën në të cilën aktvendimi i ankimuar ishte dërguar tek ai si dhe përkthimin e plotë të ankesës, dokumentet përcjellëse dhe autorizimin. Ankuesi gjithashtu ishte njoftuar për mundësinë e parashtrimit të kërkesës për ndihmën rreth përkthimit.

Më 12 prill 2009, Ankuesit përsëri i ishte kërkuar të paraqiste brenda 5 (pesë) ditëve të punës nga pranimi i urdhrin datën në të cilën aktvendimi ishte dërguar tek ai, pasi që nuk i ishte dërguar përgjigja në urdhrin e mëparshëm, si dhe përkthimin në gjuhën angleze të aktit përcjellës të përgjigjes në urdhër, të dërguar më 25 mars 2009.

Më 26 prill 2010, Ankuesi ishte përgjigjur vetëm në gjuhën shqipe.

Arsyetimi ligjor

Ankesa hedhet poshtë si e papranueshme.

Ankesa nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara nga UA e UNMIK-ut 2008/6, sepse nuk është e përcjellë me përkthimin e plotë në gjuhën angleze të ankesës dhe të të gjitha dokumenteve përcjellëse, ashtu siç është paraparë në Nenin 28.4 e lidhur me nenin 58.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6. Për më tepër, në reagimin ndaj dy urdhrave për sqarim të dërguar nga Kolegji i Ankesave, Ankuesi në mënyrë të qartë refuzoi të paraqiste përkthimin në gjuhën angleze të dokumenteve, duke theksuar se sipas Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (L-

III

03/L -006 i shpallur nga Kuvendi i Kosovës), nuk kërkohet përkthimi në gjuhën angleze. Ky mendim juridik nuk mund të ndiqet. Si *lex specialis* dhe *lex posterior*, RREG e UNMIK-ut 2008/4 dhe UA e UNMIK-ut 2008/6 mbizotërojnë qartë ndaj dispozitave e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Veç kësaj, kjo gjithashtu mund të zbatohet nga Neni 70.3 pika (a) e UA e UNMIK-ut 2008/6.

Përkthimi *ex officio*, duke e ngarkuar Ankuesin me shpenzimet, nuk ishte i nevojshëm, pasi që Ankuesi, edhe pse ishte i njoftuar rreth kësaj mundësie, nuk ka kërkuar ndihmë rreth përkthimit, Neni 25.9 i UA të UNMIK-ut 2008/6. Qëllimi i zbatueshmërisë së kësaj dispozite është i kufizuar në mënyrë rigoroze për lëndët në të cilat kërkesat për ndihmë në përkthim nuk kanë pasur sukses (refuzimi i ASC – 09 – 0087). Fjalja 3 e dispozitës në fjalë i referohet qartë fjalisë 2 (“përkthimet e tilla”). Nuk ka asnjë arsye për ta zgjeruar qëllimin e zbatueshmërisë së saj, pasi që *ratio legis* e Nenit 25.9 e UA të UNMIK-ut 2008/6 është qartë për t’i mbrojtur ata, të cilët nuk mund ta përballojnë ose besojnë se nuk mund ta përballojnë përkthimin e dokumenteve të nevojshme. Siç mund të ndodhë që disa nga ata, për arsye krejtësisht procedurale, nuk kanë sukses me kërkesën e tyre për ndihmë në përkthim, ligji dëshiron të sigurojë se gjykata përkuqdeset për atë *ex officio*, duke i ngarkuar ata më vonë me shpenzimet. Kjo nuk kishte për qëllim që t’i mbrojë qëndrimet procedurale të atyre, të cilët janë të mendimit se ata nuk duhet t’i përmbahen ligjit ose ata të cilët nuk përkuqdesen për të drejtat e tyre procedurale duke mos kërkuar fare ndihmë rreth përkthimit. Duke pasur parasysh këtë, Kolegji i Ankesave heq dorë nga qëndrimi i tij i mëparshëm të cilin e mori për këtë çështje në aktvendimin ASC – 09 – 0087.

Andaj, në pajtim me Nenin 61.4 të UA të UNMIK-ut 2008/6, Kolegji i Ankesave duhet ta refuzojë ankesën si të papranueshme.

Shpenzimet / Taksat gjyqësore

Për procedurat ankimore zbatohen taksat gjyqësore në vijim (shih ASC – 09 – 0072 etj.):

Tarifat e taksave gjyqësore, Neni 10.11 (ushtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifat e taksave gjyqësore, Neni 10.15 i lidhur me 10.21	30 Euro

IV

(Aktvendimi në shkallën e dytë)

Gjithsejtë

60 Euro

Këto taksa gjyqësore do të barten nga Ankuesi, i cili është i obliguar që të paguaj për Dhomën e Posaçme shumë të lartpërmendur.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it

nënshkrimi

Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it

nënshkrimi

Eija-Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it

nënshkrimi

Tobias Lapke, Kryeregjistrues i EULEX-it

nënshkrimi